



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 6, Datë 07.03.2014

P Ë R

**MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E RRUGËS
HYRËSE-DALËSE NGA HIDROVORI NË RESORT DHE NDËRTIMIN E
INFRASTRUKTURËS INXHINIERIKE BRENDA RESORTIT NË GJIRIN E LALZIT,
HAMALLË, BASHKIA SUKTH, QARKU DURRËS**

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e rrugës hyrëse-dalëse nga hidrovari në resort dhe ndërtimin e infrastrukturës inxhinierike brenda resortit në Gjirin e Lalzit, Hamallë, Bashkia Sukth, Qarku Durrës, me subjekt zhvillues “Lalzi Villas” sh.p.k.
2. Bashkëlidhet harta e planvendosjes së infrastrukturës, si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore Komplekse i jepet zhvilluesit vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njesisë Vendore.
4. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERJANI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT

Z. EDMOND HAXHINASTO

MINISTËR I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

SEKRETARE E KKT

Znj. ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

